



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
SEKRETARIATI TEKNIK I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT

Raport Monitorimi për realizimin e buxhetit për vitin 2015

Në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, Udhëzimit Nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit Nr. 2, datë 19.1.2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”, po paraqesim informacion mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe realizimin e shpenzimeve për vitin 2015, për Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU).

Në përdorimin e fondeve buxhetore jemi mbështetur në parimet e menaxhimit dhe funksionimit të sistemit buxhetor. Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me politikat e STKKU-së, duke pasur si synim një përdorim sa më eficient të këtyre burimeve sipas programimit të bërë për vitin 2015.

Fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2015 për STKKU-në janë 41,200,000 lekë prej të cilave 35,200,000 lekë janë parashikuar për shpenzimet korente dhe 6,000,000 lekë për shpenzime kapitale. Këto fonde sipas zërave të strukturës buxhetore paraqiten sipas tabelave të mëposhtme, ku jepen edhe realizimet përkatëse për secilin prej tyre për vitit 2015.

Tabela 1. Shenzimet Korente

Në lekë

Artikulli	Emri i Programit	Buxheti Plan 2015	Fakti deri dhjetor 2015	Diferenca
600	Paga	21,899,926	20,533,502	1,466,498
601	Sigurime shoqërore +shëndetësore	3,300,074	3,300,074	-
602	Shpenzime Operative	10,000,000	1,602,726	8,397,274
	Totali	35,200,000	25,436,302	9,863,772

Referuar tabelës nr. 1 realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korente për vitin 2015 është në masën 72%. Më poshtë analizojmë faktorët që kanë ndikuar në këtë realizim:

Mosrealizimi vërehet kryesisht në zërin Shpenzime Operative nga 10,000,000 lekë të planifikuara janë realizuar në 160,726 lekë, ose në masën 16 %. Ky realizim i ulët vjen si pasojë e faktit të kufizimeve për përdorimit e fondeve të parashikuara brenda këtij zëri për trajnime, dieta dhe konferenca të cilat zënë një masë të konsiderueshme të buxhetit të vënë në dispozicion për vitin 2015, kjo pasi një pjesë e personelit ka përfutuar trajnime të cilat janë financuar nga donatorët. Gjithashtu pranë STKKU –së ka pasur konsulencë me ekspertë të financuar nga projekti i BE-së, PPF, dhe për këtë arsye nuk janë përdorur fondet e parashikuara nga ana jonë sipas planifikimit për shpenzime për ekspertizë. Për këtë arsye janë bërë ndërhyrje në zërin Shpenzime Operative

duke shkurtuar fondin nga 10,000,000 lekë në 3,738,000 lekë, përmes aktit normativ nr. 1 datë 29.7.2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 160/2014 ‘Për buxhetin e vitit 2015’”.

Ndërsa për zërin **Paga** nga 22,000,000 lekë të planifikuara janë realizuar 20,533,502, ose në masën 93%, dhe për zërin **Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore** nga 3,200,000 lekë të planifikuara janë realizuar 3,300,074 lekë, ose në masën 103%, kjo për faktin se është bërë ndërhyje për kalimin e një shume prej 100,074 lekë nga llogaria Pagan ë llogarinë Sigurime shoqërore dhe shëndetësore, sikurse fondi i planifikuar për këtë llogari ka qenë i pamjaftueshëm.

Tabela 2. Shpenzime Kapitale

Në lekë

Llog. Ekonomike	Kod. projektit	Emri i Projektit	Buxheti Plan 2015	Fakti deri dhjetor 2015	Diferenca
2310000	M870023	Pajsje mobilim zyre	2,000,000	1,967,460	32,540
2310000	M870099	Pajisje kompjuterike	4,000,000	2,489,714	1,510,286
		Totali	6,000,000	4,457,174	1,542,826

Referuar tabelës nr. 2 realizim i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale për vitin 2015, është në masën 74%.

Për zërin **Pajsje mobilim zyre**, nga 2,000,000 lekë të planifikuara janë realizuar 1,967,460, ose në masën 98 %.

Për sa i përket zërit **Pajisje Kompjuterike**, nga 4,000,000 lekë të planifikuara janë realizuar 2,489,714, ose në masën 62%.

TË TJERA

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2015 punët kryesore të realizuara nga Sekretariati Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, sipas objektivave specifike të secilës prej drejtorive është si më poshtë vijon:

1. Në kuadër të ngritjes së një sistemi për menaxhimin e integruar të sektorit ujit është bashkëpunuar ngushtësisht me Departamentin e Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe ndihmës së huaj në Kryeministri, lidhur me Ngritjen e Grupeve për Menaxhimin e Integruar të Politikave (GMIP), kryesisht për mënyrën e ngritjes dhe funksionimit të tyre në sektorin e ujit.
2. Bashkëpunimim i vazhdueshëm me Ministrinë e Linjës të cilat prekin Sektorin e ujit, për plotësimin e Dokumentit për Planifikimin e Sektorit për përfitimin e Fondeve IPA 2016, si dhe mbajtja e kontakteve të vazhdueshme me Delegacionin e BE.
3. Hartimi i konceptit të ngritjes dhe funksionimit të Grupeve Tematike për nënsektorët përkatës në një konsultim të vazhdueshëm me Ministrinë që do të jenë lider.
4. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Ministrinë e Linjës që lidhen me sektorin e ujit për përgatitjen e udhëzimeve për funksionimin dhe rolin e grupeve Tematike.

5. Organizimi i Mbledhjes së parë të Këshillit Kombëtar të Ujit në funksionin e GMIP më datë 23.06.2015, me fokus prezantimin e konceptit dhe përcaktimin e hapave dhe detyrave në vijim.
6. Organizimi i Mbledhjes së Këshillit kombëtar të Ujit në funksion të Grupit për menaxhimin e Integruar të Politikave ku u miratua ngritja dhe funksionimi i Nëngrupeve Tematike në fushën e menaxhimit të integruar të ujit.
7. Koordinimi i procesit me Ministrinë e Linjës për prioritizimin e projekteve Strategjike, në kuader të Projektit Single Sector Project Pipeline (SSPP) të Western Balkans Investment Found (WBIF).
8. Bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës për zbatimin e reformës së Ujësjetës Kananlizimeve.
9. Dhënia e kontributit për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 -2020, për sa i përket kapitujve që lidhen me sektorin e ujit.
10. Hartimi i një draft koncepti për sistemin e integruar të Informacionit në sektorin e ujit.
11. Ndjekja e projektit për ndërtimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore;
12. Identifikimi i të gjitha programeve në Buxhetet e Ministrive të Linjës të cilat lidhen me sektorin e ujit, dhe kryerja e analizave mbi financimet e marra nga sektori në tërësi për periudhën 2010 -2014, financim i brendshëm dhe i huaj.
13. Ndjekja e të gjitha seancave degjimore të PBA-së për ministrinë e Linjës të cilat kanë programe që lidhen me sektorin e ujit.
14. Bashkëpunimi me Ministrin për Cështjet vendore në kuadër të projektit STAR, për sa i përket ndërtimin e sistemit të integruar informacionit të aseteve të UK-ve;
15. Hartimi i një analize mbi burimet njerëzore, të cilët aktualisht punojnë në sektorin e ujit, si dhe një draft koncept për rritjen e kapaciteve njerëzore në sektor.
16. Ndjekja e një sërë projektesh që lidhen me sektorin e ujit, si hartimi i Strategjisë Kombëtare të menaxhimit të Burimeve Ujore, Planit të Menaxhimit për Basenin Drinë-Bunë dhe Seman; Programi për parandalimin, përgatitjen dhe gadishmërinë për përmbajtjet në ballkanin perëndimor dhe Turqi-IPA FLOODS etj.
17. Janë kryer edhe kontrolle në terren pranë Këshillat e Baseneve Ujore dhe Agjensitë e Baseneve Ujore.
18. Organizimi i mbledhjes të Nënkomisionit të Posaçëm të Administrimit të Ujërave Ndërkufitare më datë 6.1.2015;
19. Organizimi i mbledhjes së Komisionit të Posaçëm i Administrimit të Ujërave Ndërkufitare më datë 6.1.2015.
20. Organizimi i mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Ujit më datë 17.2.2015 ku u morën vendimet e mëposhtme:
 - a) Miratimi i Vendimit nr. 1 datë 17.02.2015 të Këshillit Kombëtar të Ujit, për “Propozim për miratim, në Këshillin e Ministrave, të Projektvendimit për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbajtjet.
 - b) Miratimi i Vendimit nr. 2 datë 17.02.2015 të Këshillit Kombëtar të Ujit, për “Propozim për miratim në Këshillin e Ministrave të Projektvendimit për trajtimin e ujërave të ndotura urbane”.

21. Përgatitje e procedurës, dokumentacionit të diskutuar në mbledhjen e KKU-së datë 2.12.2015:
 - a. Miratimi i Vendimit nr. 5 datë 2.12.2015 të Këshillit Kombëtar të Ujit, për “Propozim për miratim, në Këshillin e Ministrave, të Projektvendimit për miratimin e masterplanit Kombëtar të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit dhe trajtimit të ujërave të përdorura

22. Përgatitje e procedurës, dokumentacionit të diskutuar në mbledhjen e KKU-së datë 9.12.2015:
 - a. Miratimi i Vendimit nr. 6 datë 9.12.2015 të Këshillit Kombëtar të Ujit, për “Propozim për miratim, në Këshillin e Ministrave, të Projektvendimit për miratimin e lejes për përdorim të burimit ujor për “Ndërtimin portit të jahteve në Kalanë e Turrës, ish Komuna Synej, Kavajë, Qarku Tiranë”.

23. Ndjekja e praktikave të sjella nga subjekte të ndryshme aplikuese për miratim leje për përdorim ujor.